

Art 27

**Kontratë dhurimi
ndërmjet
Republikës Federale Gjermane
përfaqësuar nga Ministria e Brendshme Federale, për Ndërtim dhe
Vendlindje, e përfaqësuar nga Presidiumi i Policisë Federale**

dhe

**Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë
të Republikës së Kosovës**

Ministria e Brendshme Federale, për Ndërtim dhe Vendlindje e Republikës Federale Gjermane, përfaqësuar nga drejtori i sektorit 4 (çështje ndërkombëtare) të Presidiumit të Policisë Federale, Z. Thomas Przybyla (në vijim i quajtur „donatori“)

dhe

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë e Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm , z. Rashit Qalaj (në vijim i quajtur „përfituesi“), lidhin kontratën e dhurimit si më poshtë vijon:

Neni 1

Me qëllim mbështetjen e Policisë Kufitare të Republikës së Kosovës në forcimin e mbikëqyrjes së kufirit, në përputhje me detyrimet e saj ligjore, Ministria e Brendshme Federale, për Ndërtim dhe Vendlindje e Republikës Federale Gjermane i dhuron Drejtorise së Policisë të Republikës së Kosovës ndihmë në pajisje me gjithsej -10- automjete Dacia Duster në vlerën e 161.900,- € (me fjalë: njëqindëgjashtëdhjetëenjë mijë e nëntëqind Euro).

Neni 2

	Pajisja	Numri	Çmimi për copë (€)	Totali (€)
01	Dacia Duster Essential 4WD 1.5blue dCI 115KF Euro 6 manuale, e bardhë VF1HJD40063074980 VF1HJD40563019134 VF1HJD40262737911 VF1HJD40763019166 VF1HJD40363019164 VF1HJD40862715153 VF1HJD40263074981 VF1HJD40562737918 VF1HJD40063778788 VF1HJD40263778789	10 (dhjetë)	16.190 € (gjashtëmbëdhjetëmijë e njëqindenëntëdhjetë)	161.900 € (njëqindgjashtë dhjetëenjë mijë e nëntëqind)

Neni 3

Me dorëzimin e sendeve të specifikuara në nenin 2 nëpërmjet donatorit kundrejt marrësit, marrësi fiton pronësinë dhe merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Pretendimet ligjore të mundshme (pretendimet lidhur me garancinë kundrejt furnizuesit dhe prodhuesit të automjeteve, garancia, si dhe të tjera) donator ja transferon përfituesit. Pas dorëzimit donatori nuk mban më përgjegjësi për operimin, mirëmbajtjen apo shpenzime të tjera të dhurimit.

Dorëzimi kryhet nëpërmjet dorëzimit real dhe të plotë të sendeve nga donatori kundrejt përfituesit ditën e sotme të nënshkrimit të kontratës dhe konfirmohet nëpërmjet nënshkrimeve të të dy palëve kontraktore si dhe nëpërmjet një procesverbali dorëzimi që do të nënshkruhet.

Neni 4

Përfituesi merr përsipër detyrimin që të pranojë sendet e specifikuara në nenin 2 të kontratës së dhurimit, t'i inventarizojë dhe të mbajë përgjegjësi më tej për funksionimin dhe mirëmbajtjen. Më tej përfituesi merr përsipër detyrimin, t'i përdorë sendet e dhururara në përputhje me qëllimin e përdorimit në veçanti për kryerjen e detyrave të policies kufitare në kufijtë shtetëror të Republikës së Kosovës.

Donatori rezervon të drejtën të tërheqë donacionin në rast se ndryshon destinacioni i përdorimit (Neni 1) i dhurimit.

Neni 5

Marrësi merr përsipër detyrimin që të paguajë kërkesat e mundshme financiare të përmendura më parë.

Neni 6


Anulimi i pjesshëm: Për sa kohë që një dispozitë e kësaj kontrate dhurimi është plotësisht apo pjesërisht e pavlefshme ose do të humbasë më pas efektin juridik, nuk do të preket vlefshëmria e dispozitave të mbetura.

Lidhur në Prishtinë më datë 06.09.2019 në katër kopje, respektivisht dy në gjuhën gjermane dhe dy në gjuhën shqipe, ku secili formulim është njësoj i detyrueshëm.


Për
Drejtorinë e Përgjithshme Policisë së
Republikës së Kosovës

Për
Ministrinë e Brendshme Federale. për
Ndërtim dhe Vendlindje
të Republikës Federale Gjermane

Drejtori i Përgjithshëm



Rashit Qalaj



Thomas Przybyla

Akt dorëzimi

Në datën 06.09.2019 përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme Federale, për Ndërtim dhe Vendlindje të Republikës Federale Gjermane, përfaqësuar nga drejtori i sektorit 4 (çështje ndërkombëtare) të Presidiumit të Policisë Federale, Z. Thomas Przybyla dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë të Kosovës, Z. Rashit Qalaj, nënshkruajnë këtë akt – dorëzimi sipas nenit 3 të kontratës së dhurimit të datës 06.09.2019.

Pranuesi i donacionit merr në dorëzim 10- automjete të reja Dacia Duster në vlerën e 161.900,- € (me fjalë: njëqindëgjatëdhjetëenjë mijë e nëntëqind Euro) në gjendje të rregullt teknike, pa asnjë vlerë tjetër.

Ky akt nënshkruhet në katër kopje të barazvlefshme, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën gjermane.

Prishtinë, më datë ..06.09.2019

Për
Policinë e
të Republikës së Kosovës



Rashit Qalaj

Për
Ministrinë e Brendshme
të Republikës Federale të Gjermanisë



Thomas Przybyla